



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 225, Datë 20.12.2019

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “SA’GA-MAT”SH.P.K., PËR HEQJEN E LICENCËS SË VEPRIMTARISË SË TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE ME NR. 254, SERIA T14P, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERVE NR.103, DATË 07.11.2014, PËR NJË AFAT 30 VJEÇAR.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, gërma “dh” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 5 gërma “dh”; nenit 7, paragrafi 2 dhe nenit 9, gërma “d”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin nr. 58, datë 18.04.2017, nenit 18 të “Rregullores për Procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019 mbasi shqyrtoi relacionin me nr.119/10 prot, datë,18.12.2019 të Drejtorisë së Licencimit , Autorizimeve dhe Mbikqyrjes mbi kërkesën e shoqërisë “SA’GA-MAT”shpk, për heqjen e licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike me nr. 254, seria T14P, miratuar me vendimin e bordit të Komisionerëve nr.103, datë 07.11.2014, për një afat 30 vjeçar.

**Konstatohet se:**

- Bordi i Komisionerëve të ERE-s me vendimin nr. 103, datë 07.11.2014, ka licencuar shoqërinë “SA’GA-MAT”shpk, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 30 vjeçar.
- Shoqëria “SA’GA-MAT”shpk, me shkresën e protokolluar në ERE, nr.748.Prot, datë 14.11.2019, ka kërkuar heqjen e licencës NR. 254, SERIA T14P, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 103, datë 07.11.2014, për shkak se nuk ushtron veprimtarinë e “tregtimit të energjisë elektrike”, për të cilën është licencuar nga ERE.
- Shoqëria në shkresën e depozituar në ERE me nr.748.Prot, datë 14.11.2019, ka parashtruar argumentat lidhur me kërkesën për heqjen e licencës.
- Shoqëria “SA’GA-MAT”shpk, ka depozituar në ERE kopje të licencës nr. 254, Seria. T14P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Rezulton se shoqëria “SA’GA-MAT” shpk, ka kryer pagesën e rregullimit, për vitin 2018, në pajtim me pikën 3.8 të kushteve të Licencës, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Me vendimin Nr.212, Datë 18.12.2019, bordi i ERE është shprehur “Mbi llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2019 nga të licencuarit”
- Afati i kësaj licence në zbatim të vendimit nr. 103, datë 07.11.2014, përfundon në datën 17.04.2044.

- Kërkesa e shoqërisë “SA’GA-MAT”shpk, për heqjen e licencës së tregtimit mbështetet në parashikimet e nenit 42, pika 1, gërma “dh”, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, në të cilin citohet se: *ERE heq një licencë me kërkesë të të licencuarit*; si dhe nenit 5, gërma “dh” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, e cila parashikon se : “*Licenca hiqet me kërkesë të të licencuarit*”,
- Rregulloreja për procedurat e heqjes së licencës në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, neni 7, paragrafi 2 përcakton se: “*Në rast se nga i licencuarit është propozuar për t’iu hequr licenca për shkak të kushteve të parashikuara në pikat “dh” dhe/ose “e” të nenit 5 të kësaj rregulloreje, ERE do të procedojë menjëherë me zbatimin e parashikimeve të nenit 9 të kësaj rregulloreje*”.
- Rregullorja për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror“, në nenin 9, gërma “d” të saj, përcakton se: “*...Bordi do të vendosë për të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat "dh" dhe / ose "e" të nenit 5 të kësaj rregulloreje, në përputhje me nenin 7 paragrafi 2 të kësaj rregulloreje*”.
- Në kushtet kur kërkesa për heqjen e licencës vjen nga vetë i licencuari, dhe legjislacioni në fuqi i sipërcituar, i jep ERE-s të drejtën ligjore për t’u shprehur me një vendim miratimi pa kaluar më parë në fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “SA’GA-MAT” sh.p.k, për heqjen e licencës së tregtimit të energjisë elektrike me nr.254, seria.T14P, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 103, datë 07.11.2014.
2. Shoqëria “SA’GA-MAT” të shlyejë detyrimet e përcaktuara në vendimin e bordit të ERE nr.212, datë 18.12.2019 brenda afatit të parashikuar në legjislacionin në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas përmbushjes së kushtit të parashikuar në pikën 2 të këtij vendimi.
4. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**